



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 392/12 prot.

Datë 02.03.2026

V E N D I M
Nr.324/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 266/2026, datë 17.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liqeni i Degës – Liqeni i Çestijes – Liqeni Merhojës dhe Kompleks i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “EM-EA Construction” SHPK, me NIPT M56827701I, dhe adresë Peshkopi Diber Peshkopi, Rruga Dali Ndeu, ndertesa nr 18.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Belsh
Adresa: Rruga “Haziz Dervishi”, Belsh.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 17.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.266/2026 ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik, “EM-EA Construction” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liqenii Degës – Liqenii Çestijes – Liqeni Merhojës dhe Kompleks i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “EM-EA Construction” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “EM-EA Construction” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 513prot., datë 20.02.2026 protokolluar me tonën nr. 392/8 prot., datë 25.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.266/2026 datë 17.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liqenii Degës – Liqenii Çestijes – Liqeni Merhojës dhe Kompleks i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 19.02.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 513prot., datë 20.02.2026 protokolluar me tonën nr. 392/8 prot., datë 25.02.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.266/2026 datë 17.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liqenii Degës – Liqenii Çestijes – Liqeni Merhojës dhe Kompleks i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh, duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e rivlerësimit të KVO datë 19.02.2026.

.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.266/2026 datë 17.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.266/2026 datë 17.02.2026, të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me REF-71378-12-09-2025, me objekt: “Krijimi i shtegut turistik “Liqenii Degës – Liqenii Çestijes – Liqeni Merhojës dhe Kompleks i Dumrea Eco Park në Marinëz”, me fond limit 16,116,156.02 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Belsh.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

